

RAPORT I VNM-së

Kompania: „Euro Via” - Sh.p.k.

ZK. Sërbicë e Poshtme, Komuna Prizrenit

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR SHFRYTËZIMIN E ARGJILES NË ZONËN KADASTRALE SERBICE E POSHTME KOMUNA E PRIZRENIT

Për Kompaninë : „EUROVIA” - SH.P.K

Titulli i Projektit : PËR SHFRYTËZIMIN E ARGJILES

Ngastra kadastrale: P-71813020-00664-1 dhe P-71813020-00664-4

Zona Kadastrale : Sërbicë e Poshtme

Komuna : Prizrenit

Investitori i Projektit: „EuroVia” – Sh.p.k

Mars, 2024

RAPORT I VNM-së

Investitori:

Kompania „EuroVia” Sh.p.k. Sërbicë e Ultë komuna e Prizrenit

Drejtor: Rexhep Gashi



v.v.



Hartuesi i Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati,

Nr. i licencës: 71/17

edonak88@gmail.com

+383 49 521 528

Dr.sc. Granit Kastrati _____ Pjesëmarrës në VNM

RAPORT I VNM-së

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Baza ligjore për hartimin e raportit	6
2.1. Rregullativa Ligjore.....	6
a) Dokumentacioni normativ	6
3. Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit	8
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit	8
3.2. Popullata dhe Vendbanimet	10
3.3. Infrastruktura ekzistuese	11
3.4. Kushtet klimatike.....	11
3.5. Erërat.....	12
3.6. Relievi	12
3.7. Hidrogjeologjia	13
3.8. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit (Përfshirë një hartë gjeologjike të rajonit).....	13
3.8.1 Kreta e Sipërme (K2.2).....	13
3.8.2 Plioceni (Pl 3)	14
3.8.3 Kuaternari (Q).....	15
3.8.4 Harta Gjeologjike e Rajonit për Kompaninë Eurovia-sh.p.k.....	16
3.9. Natyra dhe biodiversiteti.....	16
3.10. Bimësia dhe Vegjetacioni	16
3.11. Bota shtazore – Fauna.....	17
3.12. Peizazhi	17
3.13. Ajri.....	17
3.14. Uji	18
4. Përshkrimi i procesit të shfrytëzimit në mihjen sipërfaqësore	18
5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	20
5.1 Ndikimet në ajër	20
5.2. Ndikimet në Tokë	20
5.3. Ndikimet në ujë.....	21
5.4. Ndikimi në Peizazh.....	21
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	21
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	21
5.7. Zhurma.....	22
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	22
6.0. Marja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve	23
6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit.....	23
6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës.....	23
6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit.....	24
6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	25
6.5. Masat e marura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore	25
6.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	26
7. Aktivitetet në raport me publikun	26
8. Programi i monitorimit	26
9. Raportimi	27
10.0. Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të Aktiviteteve Prodhuese ..	27
10.1. Objektivat e rikultivimit	27

RAPORT I VNM-së

10.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve.....	28
10.3. Rikultivimi teknik.....	28
10.4. Rikultivimi agroteknik.....	29
10.5. Rikultivimi biologjik.....	30
11. Monitorimi pas Shfrytëzimit.....	32
12. Konkluzion.....	32

RAPORT I VNM-së

1. Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e Argjilave zjarrdurese dhe aktivitetet tjera minerare në vendin e quajtur Maçak-Maçak në zonën kadastrale Serbica e Poshtme, komuna e Prizrenit, është punuar në bazë të kërkesës së z.Rexhep Gashi pronar i kompanisë „EuroVia” Sh.p.k. Sërbicë e Ultë, Prizren, me qëllim të rregullimit të dokumentacionit për marrjen e Pëlqimit Mjedisor e pastaj lejes për shfrytëzimin e Argjilave zjarrdurese dhe aktiviteteve tjera minerare.

Në raport do të analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së shfrytëzimit të Argjilave, duke i identifikuar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të ushtrohet kjo veprimtari dhe rreth më të gjerë. Me anë të këtij raporti analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku është planifikuar të bëhet shfrytëzimi i Argjilave, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinjeroko-teknologjike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër. Andaj shtrohet nevoja për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin minierë sipërfaqësore dhe mjedis, duke mos anashkaluar edhe regjionin më të gjerë. Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së përgatitjes së mihjes sipërfaqësore për shfrytëzimin e Argjilave, gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik të shfrytëzimit, dhe pas përfundimit të shfrytëzimit të Argjilave në ngastrat nr. P-71813020-00664-1 dhe P-71813020-00664-4, zona kadastrale Serbica e Poshtme, komuna e Prizrenit.

Kompania „EuroVia” Sh.p.k. Sërbicë e Ultë, Prizren, ka si aktivitet parësor kryerjen e aktiviteteve minerare me standarde të kërkuara. Duke patur parasysh faktin se argjilat në këtë lokacioni karakterizohet me cilësi të mira fiziko-mekanike dhe përbërje kimike të mira, si dhe kualitet të lartë që kanë përdorim të gjerë në ndërtimtari si lëndë e parë për prodhimin e tullave dhe bllokave nga argjila. Prandaj pronari i kompanisë „EuroVia” Sh.p.k. planifikon të zhvillojë aktivitetin e tij në shfrytëzimin e argjilave dhe prodhimin e produkteve nga argjila si lëndë e parë që përdoret në ndërtimtari.

RAPORT I VNM-së

2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis – VNM është aprovuar Ligji për VNM Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së, Ligji për VNM nr. 08/L-181 ka për qëllim vlerësimin e përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë, zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

2.1. Rregullativa Ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë “EuroVia” shpk. e cila planifikon të bëjë mihjen dhe nxjerrjen e argjilave zjarrëduruese dhe aktivitetit tjetër minerar janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur në vijim:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM-së Nr. 08/L-181
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet
- Ligji Nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji Nr. 08/L-116 Per ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e ujërave Nr. 04/ L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025

RAPORT I VNM-së

- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajer nga burimet e palevizshme te ndotjes.
- Udhëzim administrativ MMPHI Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.

Duke i marrë parasysh ndikimet e mundshme gjatë shfrytëzimit të Argjilave Zjarrdruese, duhet të bëhet vlerësimi i të gjitha ndikimeve të mundshme, dhe duhet parapare masat mbrojtëse të mjedisit. Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe me ekspertët që do të udhëheqin procesin e shfrytëzimit të Argjilave si dhe vizitave të bëra ne teren, janë shfrytëzuar edhe:

- Elaborati gjeologjik për vendburimin e lartcekur
- Projekti kryesor për shfrytëzimin e Argjilave
- Çertifikata e biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopjet e planit të parcelave
- Informimi/Pëlqimi komunal
- Plani i situacionit
- Kontrata për marrjen ne shfrytëzim të përkohshëm e pjesës të ngastrës

Krahas parashikimeve themelore nga rregullivat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-së janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis.

3. Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokaliteti ku planifikohet të bëhet mihja dhe shfrytëzimi i argjilave gjendet në pjesën veri-perëndimore të Prizrenit afër 12 km larg nga qendra e qytetit të Prizrenit, përkatësisht në ngastrat numër P-71813020-00664-1 dhe P-71813020-00664-4 me sipërfaqe totale prej 151032.00 m², në zonën kadastrale Serbicë e Poshtme, vendi i quajtur Maçak-Maçak komuna e Prizrenit. Vendburimi i planifikur i argjilave është i lokalizuar pranë magjistralsë Prizren-Gjakovë, pranë vendburimit të argjilave gjendet edhe hekurudha që lidhë këtë pjesë të regjionit të Prizrenit me Fushë Kosovën dhe Prishtinën. Në pjesën jug-perëndimore të parcelave gjendet fshati Krajë dhe kufizohet me Fabrikën e bllokave, ndërsa në pjesën veriore gjendet fshatrat Sërbica e Poshtme, kurse në jug-lindje gjendet fshati Landovicë. Saktësisht, shtrirja e fushës për kërkim/hulumtim dhe shfrytëzim të argjilave përfshin një sipërfaqe prej 151032.00 m².

Pra, lokacioni i planifikuar për shfrytëzimin e Argjilave dhe kryerjen e aktiviteteve tjera minerare ndodhet në lokalitetin e fshatit Serbica e Poshtme komuna e Prizrenit, në anën e djathtë të rrugës së fshatit Serbicë e Poshtme gjithashtu edhe fshati Serbicë e Poshtme gjendet në anën e djathtë të rrugës magjistrale Prizren-Gjakovë në largësi rreth 1 kilometër nga kjo rrugë. Ngastrat kanë një territor me një sipërfaqe të pjerrët.

Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës. Prizreni kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpçës dhe Dragashit si dhe me shtetin e Shqipërinë dhe Maqedonin e Veriut. Rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 300 metra, ndërsa disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë rreth 2000 m të lartësisë mbidetare.

Shfrytëzimi i Argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare është planifikuar të bëhet në pjesën e ngastrave numër P-71813020-00664-1 dhe P-71813020-00664-4 me sipërfaqe totale prej 151032.00 m², zona kadastrale Serbica e Poshtme, Komuna e Prizrenit. Ngastrat në fjalë janë në posedim të kompanisë "FAT GROUP" Shpk me pronar Qamil Gashi e ka marrë në shfrytëzim të përkohshëm për 99 vite. Ndërsa kompania "EuroVia" shpk me pronar Rexhep Gashi këto dy ngastra e lartëcekura i ka marrë në shfrytëzim nga kompania "FAT GROUP" shpk me pronar Qamil Gashi me anë të

RAPORT I VNM-së

kontratës nr.ref. 1087/2022. Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku planifikohet të shfrytëzohet argjila dhe kryhen aktivitetet tjera minerare, nuk ka objekte banimi, objektet më të afërta të banimit janë në një largësi mbi 300m, prandaj s'është e nevojshme që të bëhen matjet detale sizmike të efekteve pasi që shfrytëzimi i argjilave do të bëhet pa minime.


Në bazë të rezervave të argjilave dhe bazuar në pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, në këtë lokacion ekzistojnë kushte të mira për shfrytëzimin e argjilave prandaj në këtë lokacion ekziston edhe një kompani që është duke e shfrytëzuar argjilat zjarrduruese.

Lokacioni ku planifikohet të eksploatohet argjilat shihet në pjesët e hartave topografike të më poshtme.



Sipërfaqja prej 151032.00 m² e pjesës e ngastrave numër P-71813020-00664-1 dhe P-71813020-00664-4 me sipërfaqe totale prej 151032.00 m², në të cilën planifikohet të shfrytëzohet argjila është e përkufizuar me kufijtë dhe koordinatat e paraqitura në dokumentacionin e bashkangjitur raportit të VNM-s.

RAPORT I VNM-së



3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % të territorit të Kosovës) posedon 76 vendbanime me 220.776 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000 banorë.

Komuna e Prizrenit, në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më të pasura. Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit në bazë të modelit të Austrisë, Sllovenisë, Zvicrës.

Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik.

RAPORT I VNM-së

Kjo rrugë, për arsye politike nga e kaluara sot nuk ka rëndësi aq të madhe, është një rast i mirë që me valorizimin e saj të shfrytëzohen të gjitha përparsit e saj, duke marrë parasysh që në të kaluarën ka pas ndikim primar në zhvillimin e Prizrenit. Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Prizrenit ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative. E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Prizrenit.

Prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Prizrenit. Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit të planifikuar për shfrytëzimin e argjilave dhe kryerjen e aktiviteteve tjera minerare nuk ka objekte banimi, objektet banimit gjenden në largësi rreth 300 m, nga lokacioni ku planifikohet të bëhet shfrytëzimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare, në largësi rreth 300 m gjendet një objektete e banimit që gjendet në këtë lokacion të pronarit të kompanisë „EuroVia” Sh.p.k., kështu që në pikëpamje mjedisore shfrytëzimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare, nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse disa prej këti komunitetit do të punësohen për shfrytëzimin e argjilave dhe aktiviteteve tjera minerare. Popullata e këtij rajoni merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

3.3. Infrastruktura ekzistuese

Lokacioni i planifikuar për shfrytëzimin e argjilave dhe kryerjen e aktiviteteve tjera minerare gjendet në një largësi mbi 500 nga rruga e asfaltuar e fshatit Serbica e Poshtme ndërsa nga rruga regjionale Prizren- Gjakovë është në largësi mbi 1000 metra.

Rruga e këtij fshati lidhet me rugin regjionale Prizren- Gjakovë, e që pastaj kjo rrugë të lidhë me autostraden “Ibrahim Rugova”, autostradë e cila të lidhë më Shqipërinë me pjesën Verilindore të Kosovës me Maqedonin e Veriut dhe në Pjesën Jugore me Shqipërinë. Pra këto rrugë lidhin shumë mirë lokacionin për shfrytëzimin e argjilave me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës.

3.4. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës

RAPORT I VNM-së

mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasitë e bores me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -0.5°C. Regjimi i reshjeve në komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri në 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

3.5. Erërat

Në lokacionin ku është planifikuar të kryhet shfrytëzimi i argjilave, për shkak të konfiguracionit e posaçërisht pozitës gjeografike më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore.

Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 225‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 226‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.6. Relievi

Rajoni i gjerë ku planifikohet të bëhet mihja dhe shfrytëzimi i argjlës dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare në Zk. Serbicë e Poshtme karakterizohet me një relief mesatar kodrinor – malor. Relievi me lartësin, pjerrtësinë, formën dhe konfiguracionin ndikon në ndërtimin e elementeve klimatik, në shfaqjen e rrjetit ujqor dhe të bimësisë. Vendburimi i argjilave shtrihet në terrenin kodrinor me lartsi mesatare mbidetare prej 330-620 metra. Këtu mbizotërojnë srendimentet e reja me toka argjilore të formuara nga

RAPORT I VNM-së

mbetjet liqenore me konglomerat, sendimentet argjilore, humusi dhe ndërfitje të rërës dhe zhavorrit etj.

3.7. Hidrogjeologjia

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujëra të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Drini i Bardhë. Nëpër komunën e Prizrenit kalon lumi më i madh në Kosovë, Drini i Bardhë. Drini i Bardhë, përshkon pjesën perëndimore të Kosovës, respektivisht Rrafshin e Dukagjinit për 122 km në drejtimin veri-jug, buron nga një gurrë në Bjeshkën e Rusolisë, sipër fshatit Katundi i Ri në vendin e ashtuquajtur Radavc (afër qytezës së Burimit), thellësitë e ujërave nëntokësore në këtë lokalitet nuk janë studiuar. Ujërat e lumit të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij.

Veçoritë hidrogeologjike të lokacionit ku planifikohet të bëhet shfrytëzimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare janë të thjeshta. Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të bëhet shfrytëzimi i argjilave zjarrëduruese ne zk. Serbicë e Poshtme burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, përveç ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin e Topllues e pastaj derdhen ne Drinin e Bardh i cili ekziston në distancë mbi 3000 metra ndërsa lumi topllua gjendet ne distancë 1500 metra nga sipërfaqja ku planifikohet të bëhet shfrytëzimi i argjilave.

3.8. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit (Përfshirë një hartë gjeologjike të rajonit)

Ndërtimi gjeologjik i territorit të gjerë të argjilave në këtë lokalitet është i ndërtuar nga gëlqeror të shtresëzuar të kretës së sipërme, depozitimeve të pliocenit, të cilat i përmbajnë argjilat zjarrëduruese si dhe depozitimeve aluviale. Më larg nga këto depozitim të përmendura më lartë, të cilat përbëjnë, pjesën kryesore të ndërtimit gjeologjik, për rreth Rahovecit paraqiten formacionet e serpentininit dhe diabazë - strallore. Këto formacione vetëm i përmendem mirëpo nuk janë aq shumë të rëndësishëm për këtë lokalitet ku do të bëhen kërkimi për shfrytëzimin e argjilave.

3.8.1 Kreta e Sipërme (K2.2)

Në territorin e kërkuar kreteta e sipërme përfaqëson sedimentet bazë. Janë të zbuluara në pjesën perëndimore të Zymit, me një sipërfaqe prej afro 16 km². Ato janë gëlqeror mjaft

RAPORT I VNM-së

të shtresëzuar me ngjyrë të përhimët, e cila seri ka ulje të terrenit në drejtim kah veriu. Këndi i rënies së këtyre sedimenteve është 170/25. Në pjesën jugore këto sedimente janë të mbuluara me depozitimet të pliocenit në formë të korridorit të cilët i ndajnë gëlqeroret e zymit nga gëlqeroret e Rahovecit në jug, këto depozitime mbulesore janë aluvionet rëra, zhavorri dhe lymi.

Në shtresat e gëlqerorëve është zbuluar fauna:

- Radiolites peroni
- Eoradiolites Franolii
- Nerinca forojuliansis
- Nerine m.sp. Verëijk.

3.8.2 Plioceni (Pl 3)

Depozitimet e pliocenit kanë shtrirje mjaft të gjerë në këto hapësira. Në terrenin e kërkuar, sipas pozicionit, paraqesin pjesën veri- perëndimore të depozitimeve të pliocenit, të ultësirës së Prizrenit. Në lindje në drejtim të Reqanit janë gëlqeror të turonianit ndërsa ka Zymi në perëndim takojmë gëlqeror të kretes së sipërme ndërsa në ultësirën e Drinit të Bardhë në drejtim të ardhjes së lumenjve janë të mbuluara me depozitime aluviale.

Sedimentet e pliocenit përfaqësojnë pjesën e butë të terrenit me kuota në afërsi prej 310-350 metra. Kompleksin e këtij ndërtimi sedimentlogjik e përbëjnë kryesisht argjila pluhurore me ngjyrë të verdhë, argjila ranore, rëra e imët e verdhë si dhe argjilore me zhavorrë. Anëtari dominues në këtë sedimente është argjila ranore e cila përmban pjesën dërmuese të këtyre rezervave. Në këto pjesë eksplritimi i argjilës ka filluar qysh para disa viteve e cila është përdorur si lëndë e parë për prodhimin e materialit ndërtimor gjegjësisht është përdorur për prodhimin e tullave të plota dhe bllokave për ndërtimtari. Rërat kokërr të mëdha dhe zhavorr i paraqitet në masë më të vogël dhe atë si ndërfutje të këtyre masave ranore në argjila si: rërë argjilore është e shpeshtë në shtresat e argjilës e cila seri është e volitshme dhe paraqet një seri litologjike mjaft të favorshme për prodhimin e materialit ndërtimor por vetëm me një përqindje të caktuar të përzier me argjila.

Fauna është vërtetuar në shtresat ne rëra dhe në argjila ranore e cila ceket më poshtë:

- Dreissenisa sp.
- Viviparus (Viviparus) metohiensis Pavl.

RAPORT I VNM-së

- Lithoglyphus fuscus Ziegel.
- Dreissenisa mynsteri Brus.
- Viviparus (V) conica Pavl.

Në bazë të këtyre fosileve të prezantuara më lartë është vërtetuar edhe kati Leventian gjegjësisht i takojnë pliocenin të sipërm. Karakteri i këtyre fosileve si dhe shtresëzimi i qymyreve në pjesë të veçanta të kësaj serie tregojnë në sedimentimin e regjimit liqenor të ujërave mesatarisht të ëmbla.

3.8.3 Kuaternari (Q)

Në depozitimet kuaternare takojmë aluvinet përgjatë Drinit të Bardhë dhe degëzimit të tij me lumeje Topllua dhe përroska tjera. Këto depozitime janë kryesisht zallishtore, rëra dhe suargjila. Është me rëndësi të përmendet që pjesët zallishtore të cilat paraqiten në këto depozitime janë mjaft të imëta dhe nuk kalojnë madhësinë më shumë se 60 mm.

Trashëësia e aluviale sillet rreth 4 - 6 metra, formimi i tyre vjen nga shkatërrimi i gëlqeroreve, strallore dhe diabazeve. Kanë paraqitje të rrallë edhe kokrrizat e serpentineve dhe rreshpeve dobët të kristalizuara.

Zalli dhe rëra nga Drini i bardhë shfrytëzohet në ndërtimtari për beton, për savatim dhe për prodhimin e elementeve nga betoni si kubëza etj. Për nga përmbajtja petrografike dhe analizave fiziko-mekanike të këtij materiali tregohen që mjaft me sukses mund të përdoret në ndërtimtari dhe për ndërtim të rrugëve.

RAPORT I VNM-së

3.8.4 Harta Gjeologjike e Rajonit për Kompaninë Eurovia-sh.p.k.

Harta gjeologjike në Kosova ref



Përbërja masive Gjeologjike: Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre.

Mosha: Pliocen, (Pl_{2,3}), nënkati: Piacenzian (3.600 M/vite), dhe Zanclean (5.332 M/vite).

 Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre,
 Aluvione  Proluvion

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se kjo hapësirë është ndonjë hapësirë e mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është potencial të futet zonë nën mbrojtje.

3.10. Bimësia dhe Vegjetacioni

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore.

Në bazë të shqyrtimeve vizuale në lokacionin ku do të shfrytëzohet argjila kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, si

RAPORT I VNM-së

kaçuba të qarrit, bungut, akacia etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në argjila, në këtë hapësirë gjenden edhe kaça, murrizi, mana, manaferra, etj. Pjesa e ngastrës në fjalë posaçërisht është e zhveshur diku diku e mbuluar me drunj të ultë në formë të kaçubave, pjesa e ngastrës ku do të eksploatohet argjila, nuk përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por me shume mund të shfrytëzohet edhe si zone me vlera kullose.

3.11. Bota shtazore – Fauna

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Prizrenit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahë fortë, krahë lusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat, shqiponja, lakuriqi, etj.

3.12. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin eksploatimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare –mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Projekti i lartë shënuar shfrytëzimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare nuk ka ndonjë ndikim negativ të theksuar në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar.

3.13. Ajri

Nga vetë konfiguracioni i terrenit ku do të bëhet shfrytëzimi i argjilave dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare, dhe prezenca e florës, në afërsi gjindet fabrika e materialit ndërtimor Tulltorja e nuk ka ndonjë fabrikë ose aktivitila gjithashtu bene shfrytëzimin e

RAPORT I VNM-së

agjiles dhe aktiviteve industriale për pos aktiviteve eksploatuese, thërmuese dhe selektuese të argjiles që do të ndikojnë në ndotjen e ajrit, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm, mirëpo frekvenca e automjeteve në rrugën regjionale Prizren- Gjakovë, ndikojnë në ndotjen eventuale të ajrit, ndotja e pjesërishme e ajrit vjen nga shfrytëzimi i cili behet në këtë lokalitet dhe mekanizmi të cilët përdoren për kryerjen e aktiviteve bujqësore.

3.14. Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën regjionale Prizren- Gjakovë dhe nga shpërlarja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara, pasi që ekzistojnë objekte industriale fabrika e bllokave Tulltorja në këtë lokacion, prandaj pasi nuk ka ndotës potencial të ujërave, mund të konkludojmë se pastërtia e ujit në këtë lokacion është në nivel të lakmueshëm.

4. Përshkrimi i procesit të shfrytëzimit në mihjen sipërfaqësore

Argjilat zjarrdurese i këtij lokacioni është i depozituar nga mbetjet liqenore nga alterimi i shkëmbinjve magmatik dhe metamorfik, prandaj për shfrytëzimin e argjilave nuk do të përdoret metoda e minimumit me lëndë plasëse, por do të përdoret vetëm eskavatori për gjerje të materialit të depozituar dhe pastaj me anë të eskavatorit apo lopatës ngarkuese ngarkohet në kamion për transportimin e tijë gjer te fabrika e materialit ndertimor apo deri te vendi i deponis. Për të kryer këto aktivitete nevojiten këto makina ngarkuese dhe transportuese : një ekskavator, një lopat ngarkues dhe tre kamionë me kapacitet se paku 10m³.

Punimet e shfrytëzimit të argjilave në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim. Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e shkëmbinjve sedimentar, argjilat në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:

- lartësia e shkallëve është 10m.
- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.
- pjerrtësia punuese e shkallës do të jetë 40-45°.

RAPORT I VNM-së

- eksploatimi i argjilave do të kryhet përmes 6 shkallëve.
- sterili dhe materiali humusor nëpër rrugë të projektuara do të bartët dhe deponohet ne deponin e caktuar enkas për te e pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.
- karakteristikat hidrogeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferik me punime minerare lehtë largohen nga karriera
- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota me e lartë fillestare e vendburimit nga lartësia ne nivelin e kuotës 360m deri nga thellësia ne nivelin e kuotës të shkallës 310m.

Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë.

Etazhet zhvillohen në drejtim veri-jug, dhe atë në një katë bëhet përgatitja e fushës për eksploatim, kurse në katin (etazhin) më lartë bëhet ngarkimi dhe transporti i masës së mihur më herët. Mënjanimi ose largimi i shtresës së dheut homusit gjerë sa të arrimë në shtresat e argjiles, shtresa e dheut është e ndryshme dhe atë prej 0 deri 0.5 m. Largimi i shtresës së dheut bëhet me eskavator duke e larguar në një vend të caktuar që nevojitet për deponimin e dheut që do të nevojitet për mbushjen e sipërfaqes së sipërme nga ku është shfrytëzuar i argjilave zjarrduruese.

Dheu duhet të largohet dhe deponohet ne atë distancë e cila e bën të mundur shfrytëzimin pa pengesë të argjilave, duhet pasur kujdes që gjatë largimit te dheut të mos përzihet me argjila sepse pataj do te jet penges ne procesin e prodhimit.

Mihja e argjilave do të kryhet pas largimit të shtresës së dheut, argjilat mihen me anë të ekskavatorit dhe atë sipas përshkrimit dhe rregullave për shfrytëzim në bazë të projektit xehetar të shfrytëzimit, në këtë vendburim shfrytëzimi i argjilave do të kryhet përmes gjashtë shkallëve.

Transporti i argjilave, gjatë gërmimit te argjiles drejtë për drejtë me ekskavator ngarkohet në kamion transportues, ose me ekskavator vetëm gërmohet e pastaj me lopatë ngarkuese ngarkohet në kamion transportues për tu transportuar gjer në vendin e destinuar.

RAPORT I VNM-së

5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

5.1 Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore për shfrytëzimin e argjilave ndikim negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit.

Në zonën e shtrirjes së trupit mineral ajri është i pastër. Deri te ndotja vë për shkak të punëve dhe aktivitetit në mihjen sipërfaqësore, sidomos në fazën e gërmimit, ngarkimit dhe transportit.

Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës, por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi se ato janë larg nga lokacioni ku do të shfrytëzohet argjila.

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të gazrave, nga automjetet e grryerjes ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës. Përbërja e Argjilave gjatë fazes së shfrytëzimit nuk përmban materie të dëmshme.

5.2. Ndikimet në Tokë

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa e dheut (steril) e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës. Sipas të dhënave gjeologjike, trashësia e shtresës së djerrinës (sterilit) sillet nga 0.50 deri 3.5m. Për llogaritje është marrë trashësia mesatare 2.0m. Lokacioni i zgjedhur për depozitimin e djerrinës ka hapësirë të mjaftueshme për palosje të sasisë së masave të djerrinës të sipërshënuara.

Nuk ka nevojë të ndërtohen rrugë të posaçme pasi që shfrytëzohen rrugët ekzistuese. Si ndikime negative kemi humbjen e një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës brenda kontureve shfrytëzuese.

Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

RAPORT I VNM-së

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku planifikohet të shfrytëzohet landa e parë argjila, do të merr pamjen e një vendi industrial.

Gjatë fazës së shfrytëzimit të argjiles normalisht, peizazhi do të pësojë një degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt me gjendjen e mjedisit.

Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit të pasurive /resurseve natyrore.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në mihjen sipërfaqësore për shfrytëzimin e argjilave zjarrdrueser dhe ate ne sipërfaqet operacionale në gjatësinë kohore të shfrytëzimit të argjilave flora tërësisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punimeve minerare.

Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga zona ku do të bahet shfrytëzimi i argjilave dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në kompleksin e punimeve minerare për shfrytëzimin e argjilave ne afersi nuk ka objekte banimi, nuk do të kemi ndonjë rastë të zhvendosjes së popullatës dhe as që pritet në të ardhmen të ketë për shkak të punimeve minerare për shfrytëzimin e argjilave ne këte lokalitet.

Zhvillimi i veprimtarisë për shfrytëzimin e argjilave në këtë lokalitet ka një rëndësi të veçanet për popullatën e këtij rejonit. Pronari i Kompanisë „EuroVia” Sh.p.k. për të zhvilluar veprimtarinë e vet do të jetë i obliguar të punësojë një numër të madh të

RAPORT I VNM-së

punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase, nga kjo del se në aspektin social shfrytëzimi i argjilave do të ketë ndikime pozitive. Argjilat e këtij vendburimi përpos pluhurit nuk përmban materieje të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

5.7. Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e shfrytëzimit të argjilave ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni. Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve minerare kryesisht nga makinat gjatë procesit të grryerjes, ngarkimit dhe transportit etj.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar do të jetë jetë plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk do të kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk do të punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore për shfrytëzimin e argjilave mekanizmi punues do të jen mirë të mirëmbajtura, dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe një herit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, por thjeshtë me materialin që e marrim po nga ky mjedis. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

- Gjatë përgatitjes së fushës për shfrytëzim
- Gjatë mihjes (gërmimit- grryerjes), ngarkimit dhe transportit
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).

6.0. Marja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve

6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytëzimin e argjilave dhe aktiviteteve tjera minerare të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në mihjen sipërfaqësore të gjitha sipërfaqet operacionale dhe rrugët (pjesët e pa asfaltuara) ku do të bëhet transportimi i masës së argjilave duhet vazhdimisht të stërpiken me ujë.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda punuese me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate.
- Duhet rregullisht të jetë në disponim cisterna me ujë rezervë për stërpikjen e sipërfaqeve operacionale ne kohra të thata dhe posaqërisht kur kemi intenzitet më të madhë të erërave.

6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimi i proceseve teknologjike për shfrytëzimin e argjilave duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.
- Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rekultivim biologjik.
- Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e mundur.
- Varësisht nga fronti i punëve në minierë, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç' rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të argjilave.
- Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës dhe shperndarjes se baltës.

RAPORT I VNM-së

- Duhet të merën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin ku eksploatohet argjila për shkak të avarive në makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në minierë duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë të shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontejnerë të posaçëm të cilët do të i zbrazin kompanitë që kanë veprimtarin e grumbullimit të tyre dhe të i dërgojnë në deponin rajonale.
- Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Depoja ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdorura të thurret me mur statik si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet, në të vendoset sistemi i bartjes së ujërave gjër në Seperator të vajrave.
- Makinat për mihje (gërryerje, ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes së orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to.

6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit


Mbrojtja e mihjes sipërfaqësore nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përfaqë sipërfaqes së mihjes sipërfaqësore. Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e mihjes sipërfaqësore nga vërshimet gjatë të reshurave atmosferike, dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e mihjes sipërfaqësore gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen pusët sedimentuese për sedimentimin e materieve të ngurta dhe separatori për

RAPORT I VNM-së

pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale të mihjes sipërfaqësore, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e pastra të lëshohen në recipient. Seperatori duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe seperatori. Në mihjen sipërfaqësore gjithmonë duhet të ketë në disponim absorbues të vajrave dhe derivateve.

Ne vijim po e paraqesim shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura.

Shema teknologjike e trajtimit të ujërave



Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen në recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara.

6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se niveli i zhurmës e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat e marura për mbrojtjen e botës bimorë dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimorë kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në pjesën e ngastrës shfrytëzuese nga erozioni dhe masave mbi mbrojtjen e ajrit. Kompania

RAPORT I VNM-së

„EuroVia” Sh.p.k. duhet të ketë kujdes që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.

Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës ne te cilën bëhet shfrytëzimi i argjilave dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit etj.

6.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë shfrytëzimit të argjilave duhet ndërrmar këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të kenë ne disponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet e tërë fusha shfrytëzuese të thuret me tel gjembor.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7. Aktivitetet në raport me publikun

Meqë kompania „EuroVia ”- sh.p.k, nga komuniteti ka respekt, për arsye të zbutjes së papunësisë në këtë lokalitet, duke pasur parasysh llojin e projektit, kapacitetin e prodhimit dhe potencialit të ndikimeve në mjedis, edhe pse ka pasur konsultime me komunitetin prap planifikon që të ketë debat të veçantë me publikun.

8. Programi i monitorimit

Ndikimet direkte nga aktiviteti i realizimit të proceseve teknologjike për shfrytëzimin e argjilave, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për mihjen sipërfaqësore. Monitorimi i ajrit, tokës dhe ujit duhet të

RAPORT I VNM-së

